

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e IC "SCARDIAN" JSC:

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të IC "SCARDIAN" J.S.C" (Kompania), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parash për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parash për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona në këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit në auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera financiare në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

### Theksim i çështjes

1. Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 3.2 "Bazat e Përgatitjes" për këto pasqyra financiare, i cili përshkruan mospërputhjen me rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2016 dhe planin e menaxhmentit për të korrigjuar këtë mospërputhje. Raporti ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.
2. Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 5.6 të pasqyrave financiare i cili përshkruan mospërputhjen e Kompanisë me raportin e "Mbulueshmërisë së rezervave teknike me pasuri - Rregullorja për investimin e pasurive që mbulojnë provizionet teknike dhe investimi i kapitalit themeltar për siguruesit" më 31 dhjetor 2016. Mungesa e mjeteve që mbulojnë provizionet teknike është 602,544 Euro. Raporti ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për një kontroll të tillë që konsiderohet e nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për vazhdimësinë e biznesit, duke shpalosur, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e biznesit dhe përdorë parimin e vazhdimësisë së biznesit, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë. Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

## Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale, nëse ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritët të ndikojnë tek përdoruesit në vendimet ekonomike të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe, dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa ai që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të dëshmive të auditimit të siguruar, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë së Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në dëshmitë e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditorit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmën mund të shkaktojnë ndërprerjen e parimit të vijimësisë së Kompanisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Kosova sh.p.k.*

Deloitte Kosova Sh.p.k  
Str. Lidhja e Pejës nr.177  
Prishtina, Republic of Kosovo  
Registration No. 80452632  
28 prill 2017

**IC "SCARDIAN" J.S.C**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016**  
*(shumat në Euro)*

<b>Pasuritë</b>	<b>Shënime</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016 EUR</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015 EUR</b>
<b>Pasuritë rrjedhëse</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e parashë	6	460,929	858,976
Depozitat e afatizuara	7	4,833,333	3,800,007
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi	8	148,081	34,750
Kostot e shtyera të blerjes	9	684,818	366,101
Pasuri tjera financiare	10	125,000	125,000
Parapagimet dhe pasuritë tjera	11	368,177	184,262
<b>Gjithsej pasuritë rrjedhëse</b>		<b>6,620,338</b>	<b>5,369,096</b>
<b>Pasuritë jo-rrjedhëse</b>			
Prona dhe pajisjet	12	548,099	525,089
Pasuritë e paprekshme	13	99,570	29,910
<b>Gjithsej pasuritë jo-rrjedhëse</b>		<b>647,669</b>	<b>554,999</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>7,268,007</b>	<b>5,924,095</b>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>			
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Rezerva për dëmet në process	14	1,717,586	412,535
Rezervat e primit të pafutur	15	2,768,739	1,401,745
Detyrime tjera	16	270,097	263,001
<b>Gjithsej detyrimet rrjedhëse</b>		<b>4,756,422</b>	<b>2,077,281</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar		5,000,000	5,000,000
Humbjet e akumuluar		(1,153,186)	(189,974)
Humbjet e vitit aktual		(1,335,229)	(963,212)
<b>Gjithsej kapitali</b>		<b>2,511,585</b>	<b>3,846,814</b>
<b>Gjithsej kapitali dhe detyrimet</b>		<b>7,268,007</b>	<b>5,924,095</b>

Autorizuar për publikim nga menaxhmenti i kompanisë më 28 prill 2017:

  
**Arben Aydyli**  
Drejtor Ekzekutiv

  
**Fatos Krasniqi**  
Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare